

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Koka: Ron Yeffet po bën milionat me paratë e taksapaguesve shqiptarë. Pazare të rrezikshme nën flamurin e NATO
ADRESA	https://piranjat.al/politike/koka-ron-yeffet-po-ben-milionat-me-parate-e-taksapaguesve-s-hqiptare-paz-i104306
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 18:42:55 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 18:39:08 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1eca5b72bce9c918cf59b00cc0988e29b116bbefb6a4f3331e5d6d727afdc7ca
TEKSTI	67928fc3e3343a2309ffa8dc59b95905b40876d871b4c13185299d5eb53a1bdd
PAMJA	71400dcd44d08e99c2bedc940cf8b8193e9e6a5eb2591479eb54c1c169dcc826

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1b31ec220abf14006f1197e88b139a4d2f222b11c5729b93235eb69347b3dacd
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7fc79e204ff2dfa3f9e677f0c9d1bacea0122705418ff355483188747d3235b5
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr të eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/1b31ec220abf14006f1197e88b139a4d2f222b11c5729b93235eb69347b3dacd

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKE
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: **Saudite anulon dërgesat** për klientët evropianë, të **rasti i dajes së Zegjine** "Pranisë Besnikë", kryeministri **vendoset edhe për pagat e** ndryshime në përbërjen e **shqiptare është e furnizuar** tati, ushtria shqiptare sot **me lehtësira fiskale** Demokratike kërkon nga qeveria që të lëshojë...

POLITIKE

Koka: Ron Yeffet po bën milionat me paratë e taksapaguesve shqiptarë. Pazare të rrezikshme nën flamurin e NATO

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 20:39



Gazetari Bledian Koka, i ftuar në emisionin 'Ora 19' në SYRI TV me moderatoren Armela Ferko, komentoi përgjimet dhe deklaratat e fundit lidhur me Roni Yeffet dhe marrëdhëniet e tij me strukturat shtetërore shqiptare.

Sipas gazetarit, çështja nuk mund të reduktohet thjesht në marrëdhënie biznesi apo në 'pazare', pasi bëhet fjalë për përdorimin e parave të taksapaguesve shqiptarë dhe për interesa që, sipas tij, shkojnë përtej Shqipërisë.

Ai akuzoi qeverinë Rama se paratë publike mund të përdoren edhe për atë që e cilësoi si 'PR ndërkombëtar', me synimin për të krijuar jashtë vendit një imazh të Shqipërisë që, sipas tij, nuk përputhet me realitetin e brendshëm.

Koka e lidhi këtë edhe me mënyrën se si trajtohen në arenën ndërkombëtare zhvillimet në Shqipëri, duke ngritur paralelisht pikëpyetje mbi takimet dhe marrëdhëniet e kryeministrit Edi Rama me persona të dyshuar për lidhje kriminale.

'Është konfirmimi i asaj që ishte kryefjala sa i takon çështjes në fjalë të zotit Ahmetaj, i cili tha që Roni Efeti është Gysi i ri, Gysi Agasi i ri i Edi Ramës, kësaj here në nivel ndërkombëtar.

Dhe në fakt, fiks ajo që thotë zoti Ahmetaj përmes atyre përgjimeve që dëgjua edhe mbrëmë e ndjeshme në emisionin e kolegut Peka, realisht është konfirmimi i kësaj gjëje.

Po, shumë njerëz që mund ta shikojnë, dakord, është njëri që bën, bën ca pazare, mund të mendojë dikush. Problemi është që nuk është se është vetëm njëri që bën ca pazare. Është njëri, që me paratë e taksapaguesve shqiptarë, një i huaj, domethënë e përcakton ai se si do shpërndahen, sa do marrë, si do i shijojë, se si ky njeriu që është në 15-vjeçarën e vet të jetës aktive do të bëjë miliona.

Dhe këto miliona do t'i bëjë me taksat tona dhe sigurisht për llogari të Edi Ramës dhe sigurisht për llogari të interesave të tij, për të, me të cilat këto pagesa, këto shuma të cilat nuk janë vetëm brenda por tashmë futen në qarkullim ndërkombëtar, janë më të lehta si me thënë për të bërë atë që zakonisht është e vetmja gjë që e mban si me thënë Edi Ramën në xhiro dhe që është korruptimi dhe PR-i ndërkombëtar i sponsorizuar me paratë e taksapaguesve shqiptarë për të dhënë një realitet në Shqipëri që nuk ekziston. Pra për të thënë kur, kur këtu si me thënë, kur del që Edi Rama në fakt pritet në zyrën e vet njerëz të kartelit... të lidhur me kartelin e Sinaloas, këtu do të dali që në fakt kjo Shqipëria është Maldivet e Evropës.

Kjo nuk është e pavërtetë. Problemi është që prevalon kjo dhe duke bërë këtë lloj reklamimi, u mbyllin gojën atyre mediave që mund të flasin për të vërteta që janë shumë herë më të rëndësishme dhe që rëndojnë shumë e më shumë popullin shqiptar, që janë pikërisht ato, kundërvajtje penale, dhe e them me plot gojë kundërvajtje penale, që bën zoti Rama qoftë në aktivitetin e tij brenda Shqipërisë, ashtu edhe në arenën ndërkombëtare.

Sepse këtu, në rastin e Roni Efet, jemi në kundërvajtje penale ndërkombëtare sepse nëse një drejtësi funksionale do të vepronte dhe do të niste hetimet, për atë që ka thënë Ahmetaj dhe për deklaratat që më pas u bënë, po të doni, nga zyrtarët e Ministrisë së Mbrojtjes, zyrtarët e MEICO-s dhe zyrtarët e kompanisë Timak Defense në emisionin e kolegut Blendi Fevziu, realisht ato janë deklarata penale.

Po janë deklarata penale sepse ne mbajmë mend sinkronin e famshëm të ministrit Nuçi që thotë që ne, Shqipëria po prodhon armë dhe madje këto armë po, janë duke u përdorur edhe në zonat e konfliktit.

Dhe fiks tre muaj më mbrapa, del zëvendësministria e zotit Nuçi dhe thotë: 'në dijeninë time, jo vetëm që ne nuk prodhojmë armë, por në dijeninë time - thotë ajo ligjore - as nuk eksportojmë armë'. Tani pyetja është: eksportohet apo nuk eksportohet armë? Pse kemi një deklaratë nga Ministri i Mbrojtjes që thotë 'prodhojmë dhe eksportojmë' dhe pse kemi një deklaratë nga zëvendësministria...

për trafikun ndërkombëtar të armëve. Ku krejt papritur ajo thotë, jo s'eksportojmë armë neve, as prodhojmë as nuk eksportojmë. Pra që këtu, lind dyshimi i arsyeshem, do thoshte një jurist, për SPAK-un që të nisi hetimet dhe t'i thrasë menjëherë...

Po, pra po, të thërrasi menjëherë, jo të vëjë e t'i kthejë sytë e të thotë 'vëmë një çik në dispozicion atë që pamë mbrëmë në televizor'. Po të thrasë menjëherë, kur është drejtësi e pavarur, menjëherë e thërrret në dijeninë atë, Ministrin e Mbrojtjes, drejtuesin e MEICO-s, drejtuesin e Timak-ut, e Ronin, e shefin e Ronit po të doni. Sepse të gjitha këto gjëra nuk janë thjesht ca pazare të cilat bëhen në kurriz të taksapaguesve shqiptarë, por janë ca pazare të rrezikshme të cilat bëhen nën atë që është flamuri i dytë i Shqipërisë mbas flamurit kuq e zi, që është flamuri i NATO-s, vend ku ne jemi anëtarë, sigurisht.', tha gazetari Bledian Koka në SYRI TV.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 15 Shtator20:35

[Protesta e 108/ Mbyllen fjalimet, nis marshimi në rrugët e Tiranës](#)

Po mbahet sot në 15 shtator protesta e 108 në kryeqytet kundër qeverisë. Sapo janë mbyllur edhe fjalimet e aktivistëve, të ci...

POLITIKE 15 Shtator20:31

[“Të enjten, ora 10:00, të gjithë te Parlamenti i Krimit!”- Aktivisti Arben Kola thirrje qytetarëve: Të gjithë në shesh](#)

Aktivisti Arben Kola ka bërë një thirrje për qytetarët për protestën e së enjtes, duke njoftuar se Parlamenti do të...

POLITIKE 15 Shtator20:26

[Dëgjesat për ndarjen territoriale/ Divjaka kundër shkrirjes me Lushnjën, Gorreja: Po vendosin vetëm mbi një “fotografi” të 2025](#)

Turi i dëgjesave publike të Komisionit të Këshillit Bashkiak për reformën administrativo-territoriale është ndalur mbrë...

POLITIKE 15 Shtator20:22

[“Je rrezik për vendin”/ Protestuesi shpërthen ndaj Ramës: Nuk na shuan dot kurrë si komb](#)

Një nga protestuesit në ditën e 108 hodhi akuza të forta ndaj kryeministrit Edi Rama. Protestuesi u shpreh se Rama është rrezik p&...

POLITIKE 15 Shtator20:08

[“Veliaj në qeli, radhën e kanë Rama dhe Balluku”, Arben Kola thirrje SPAK: Vazhdo me arrestime, çliro Shqipërinë nga krimi](#)

Në protestën e 108-të para Kryeministrit, aktivisti Arben Kola ka bërë thirrje për vijimin e protestave dhe rritjen e presio...

POLITIKE 15 Shtator20:07

[FOTOLAJM/ Ky është daja i Zengjine Caushit, akuzohet se përdhunoi 34-vjeçaren!](#)

Deputetja e PS, Zengjine Caushi ka reaguar me një deklaratë publike në lidhje me përfshirjen e dajës së saj në një rast d...

POLITIKE 15 Shtator19:51

[Përgjimet e Ron Yeffet, Edison Lika thirrje SPAK: Hetoni Ramën! Çoni në Kuvend kërkesë për arrestin e Ballukut](#)

Në protestën e 108, protestuesi Edison Lika tha se pasi Erion Veliaj u mbajt në burg sot me vendim të Gjykatës së Lartë, radh...

POLITIKE 15 Shtator19:38

[Ron Yeffet në përgjimet e bujshme, Bushkolaj: 'Akses i pakufizuar' te milionat, pse nuk vepron SPAK?](#)

Audiopërgjimet e publikuara së fundmi kanë ngritur pikëpyetje mbi rolin e Ron Yeffet dhe aksesin që ai pretendohet se kishte në &c...

POLITIKE 15 Shtator19:27

[Daja i saj premtoi vend pune dhe abuzoi me ish-bashkëjetuesen, Zegjineja thyen heshtjen](#)

Deputetja socialiste Zegjine Çausi ka bërë një reagim publik lidhur me ngjarjen e ndodhur dy ditë më parë në Roskove...

POLITIKE 15 Shtator19:25

[Shqipëria proteston! Denoncimi i fortë i qytetarit: Jam me epilepsi dhe nuk marr kemp](#)

Një nga qytetarët në protestën e 108 publikoi disa dokumente, ku tregoj se ishte me epilepsi. Ai u shpreh se është 64 vjeç...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 15 Shtator

[Sulmohet Arabia Saudite, bombardohet me raketa ...](#)

Huthët e Jemenit, të mbështetur nga Irani, kanë nisur një valë të re sulmesh ndaj Arabisë Saudite, ndërsa paralel...

BOTA 14 Shtator

[“E drog*va dhe abuz*va gruan per 20 vite”/ Bash...](#)

Një burrë britanik pranoi sot se kishte droguar dhe përdhunuar gruan e tij në shtëpinë e tyre për rreth dy dekada. Burri, ban...

AKTUALITET 15 Shtator

[Rrëfihet 34-vjeçarja: Daja i Zegjine Caushit më...](#)

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak ditë më parë në Roskovec, ku Bledar Bakaj shkoi në shtëpinë e ish-bashkë...


INVESTIGIME 31 Maj14:01

[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)


Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video





Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave





Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.